



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

**Grante për projekte dhe bursa studimi Master/ Postmaster
nga Fondi Ndërkombëtar i Visegradit**

Fondi Ndërkombëtar i Visegradit (The International Visegrad Fund, IVF) ndër vite ka akorduar grante për projekte të përbashkëta kulturore, shkencore dhe arsimore, për shkëmbime rinore, për projekte ndër-kufitare dhe projekte për promovimin e turizmit, si dhe bursa për studime pasuniversitare në kuadër të programeve individuale të mobilitetit.

Fondi Ndërkombëtar i Visegradit (The International Visegrad Fund, IVF), është një organizatë ndërkombëtare e Grupit të Visegradit (V4) me bazë në Bratislavë, e themeluar nga qeveritë e vendeve të Republikës Çeke, Hungarisë, Republikës së Polonisë, dhe Republikës së Sllovakisë në Štířín në vitin 1991. Të gjitha vendet V4, të cilat janë anëtare në Bashkimit Evropian, janë pjesëmarrëse të proceseve të integritit të tyre në BE, si një tjetër hap përpara përmes mbështetjes së ndërsjellë.

Misioni kryesor i Fondit Ndërkombëtar të Visegradit (The International Visegrad Fund, IVF) është të promovojë bashkëpunim sa më të ngushtë mes vendeve të Visegradit dhe popujve të rajonit. Që nga themelimi i saj, Fondi ka mbështetur mbi 3,800 projekte në kuadër të granteve të akorduara dhe ka financuar mbi 1700 bursa studimi për studentë dhe artistë në vlerë të përgjithshme prej 54 mil €. Vitet e fundit Fondi Ndërkombëtar i Visegrad-it ka rritur ndjeshëm numrin e granteve për mbështetjen e aktiviteteve në vendet jashtë zonës V4 dhe, kryesisht në vendet e Ballkanit e perëndimor. Gjatë Presidencës çeke (V4) në vitin 2011-2012, me partnerë të vendeve të Ballkanit Perëndimor u diskutua mundësia për krijimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor (Western Balkan Fund) bazuar në eksperiencën e shkëlqyer të Fondit Ndërkombëtar të Visegrad-it. Fondi rajonal i Ballkanit pritet të themelohet së shpejti.

Grupi i Visegrad-it (Çekia, Hungaria, Polonia dhe Sllovakia) e njohur edhe si "Katërshja e Vishegradit" ose thjesht "V4" po punojnë së bashku në një numër fushash të interesit të përbashkët në kuadër të integritit evropian.

Kontributet në IVF janë rritur gradualisht në vitin 2014 dhe llogariten në 8 mil. EUR në total, ose në 2 mil. EUR për secilin vend anëtar të grupit V4. Sipas llojeve të programeve, IVF 4 ofron grante për vendet V4, grante për vendet e Partneritetit Lindor (V4EaP), grante për vendet e Ballkanit Perëndimor (Visegrad +), grante për bursa studimi master ose post master (1-4 muaj) në kuadër të programit "Visegrad Scholarship Program (VSP)". Në kuadër të mbobilitetit po zbatohet "The Visegrad Artist Residency Program (VARPs) për aplikantë të fushës së artit nga vendet e Visegradit (V4). Projektet mbështeten nga **Grante** të ndara sipas kategorive në vijim:

1. **Grante të vogla/ standarde** që janë një pjesë integrale e IVF që nga fillimi i ekzistencës së tij. Aplikuesi për grant mund të jetë nga vendet e grupit V4 ose nga vendet e rajonit. Grantet e vogla ofrohen deri në 4 herë në vit ndërsa grantet standarde ofrohen deri 2 herë një vit.

Grantet e vogla/ standarde jepen për projekte që mbulojnë fushat e bashkëpunimit kulturor, të shkëmbimeve shkencore dhe kërkimore, arsimore, rinore, të bashkëpunimit ndërkuftar ose të promovimit e turizmit. Kontributi maksimal i Fondit për Grantet e Vogla për çdo projekt është 6,000 €. Koha maksimale për zbatimin e projekteve të propozuara është 6 muaj. Për projektet standarde shuma e zakonshme e grantit arrin në vlerën 10,000 €.

Shumica e pjesëmarrësve në këto projekte janë organizatat jo-qeveritare dhe organizatat e shoqërisë civile (OJQ dhe OSHC-ve), komunat, shkollat dhe institucionet e tjera publike.

2. **Grante strategjike** brenda vendeve V4 të Visegradit filluan të zbatoheshin nga viti 2005. Fondet në kuadër të granteve strategjike jepen për projekte me kohëzgjatje për një periudhë 12-36 muaj (1-3 vjet). Shuma maksimale e grantit është 50,000 €. Zbatimi i tyre synon forcimin e bashkëpunimit ndërmjet vendeve të grupit V4.
3. **Visegrad University Studies Grant (VUSG)**, është një program grantesh i projektuar për universitetet me qëllim për të promovuar dhe mbështetur zhvillimin e kurseve universitare ose programeve të veçanta studimi (cikël i plotë). Granti u jepet departamenteve universitare, shkollave, fakulteteve, të cilat do të paraqesin një projekt program të plotë mësimor të planifikuar afatgjatë, të miratuar nga Ministria e Arsimit të vendit të aplikantit. Afati i fundit për aplikim është data **10 nëntor 2015**.

Aplikimi bëhet nëpërmjet sistemit të aplikimit online me dokumentacionin shoqëruar. Të gjitha dokumentet (me përjashtim të dokumenteve të regjistrimit dhe / ose të kartës së identitetit) duhet të përkthehen në gjuhë angleze nga përkthyes të licencuar. Dokumentet së bashku me formularin e aplikimit duhet të përcillen në një paketë të vetme edhe me postë në adresën:

*International Visegrad Fund
Kráľovské údolie 8
811 02 Bratislava
Slovak Republic*

Nënvizojmë se nuk do të pranohen dokumente të dërguara më vete ose jashtë afateve të përcaktuara nga Fondi Ndërkombëtar i Visegrad-it. Afatet e fundit për aplikim sipas kategorive të lartpërmendura për këtë vit janë datat: **1 shtator 2015, 10 shtator 2015, 10 nëntor 2015**.

Për një informacion më të hollësishëm lidhur me llojin e financimit për grantet dhe bursat që ofrohen, mënyrës së plotësimit të formularit të aplikimit, përgatitjes së dokumentacionit, dispozitave dhe kushteve të tjera që duhet të plotësojë aplikanti, referojuni adresave të mëposhtme të internetit:

<http://www.mzv.cz/tirana>;

<http://visegradfund.org/scholarships/incoming/>

http://visegradfund.org/wordpress/wp-content/uploads/download/v4fund_VSP_rules.pdf

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE